



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe veterinarisë

Departamenti: Pemëtari - Vreshtari

Programi: Pemëtari Vreshtari

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Fatijon Gashi, me titull:

“Hulumtimi i mbirjes së kokrrave të polenit te kultivari i mollës Delishes i artë”

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 29.02.2024 deri me datë 06.03.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. dr. Bedri Dragusha kryetar
2. Prof. asoc. Vahid Avdiu mentor - anëtar,
3. Prof. ass. Gëzim Hodolli anëtarë, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. asoc. Vahid Avdiu , përmes e-mail adresës vahid.avdiu@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji është mund të jetë një pasurim i punës tonë !

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

DEPARTAMENTI PEMËTARI -VRESHTARI

PROGRAMI PEMËTARI -VRESHTARI



Tema:

“HULUMTIMI I MBIRJES SË KOKRRAVE TË POLENIT TE

KULTIVARI I MOLLËS DELISHES I ARTË”

Mentor:

Prof. Asoc. Dr. Vahid Avdiu

Kandidati:

Bsc. Fatijon Gashi

Prishtinë, 2024

ABSTRAKTI

Në vitin 2023 në fermën didaktike të FBV-së dhe në laboratorin e Pemëtarisë është kryer studimi mbi hulumtimin e mbirjes së kokrrave të polenit tek kultivari i mollës Delishes i artë. Njëkohësisht në këtë hulumtim është përfshirë edhe formimi dhe zhvillimi i frutave në bimët ku janë marrë lulet për hulumtim si dhe ndikimi i faktorëve klimatik në këtë proces. Pjalnimi dhe pllenimi janë bazat kryesore mbi të cilat zhvillohet frutifikimi i suksesshëm i mollës. Mbirja e kokrrave të polenit është një prej proceseve më të rëndësishëm gjatë pllenimit që rezulton me formimin e farës dhe zhvillimin e frytit. Si një proces i ndërlikuar mbirja e kokrrave të polenit ndikohet nga shumë faktorë të jashtëm dhe të brendshëm. Ky studim ka për qëllim të vë në pah ndikimin e disa prej këtyre faktorëve në mbirjen e polenit te kultivari i mollës Delishes i artë, në kushtet agrometeorologjike të Prishtinës. Gjatë procesit të hulumtimit është përdorur metoda e “pikës së varur” përkatësisht përdorimi i tretësirës së saharozës si teren ushqyese për mbirjen e kokrrave të polenit. Lulet janë marrë në tri fenofaza të lulëzimit: fillimi i lulëzimit, lulëzimi i plotë dhe përfundimi i lulëzimit, pastaj kokrrat e polenit të veçuara nga anterat janë vendosur në tretësirat e saharozës me përqendrim 10%, 15% dhe 20%. Prosesi i mbirjes është vëzhguar në përmes mikroskopit elektronik për 120 minuta (10’ 20’ 30’ 40’ 50’ 60’ dhe 120’), dinamika e mbirjes së polenit është regjistruar përmes fotografive të realizuara përmes kamerës së mikroskopit. Gjatë hulumtimit të mbirjes së kokrrave të polenit është vërejtur se një pjesë e kokrrave të polenit nuk arrijnë të mbijnë, një pjesë arrijnë vetëm të fillojnë mbirjen pastaj gypi gjerminativ nuk zgjatet, një pjesë tjetër para ose pasi të fillojnë të mbijnë dhe gjatë zhvillimit të gypi gjerminativ shpërthen (aborton) dhe një pjesë tjetër arrijnë të zhvillojë normalisht gypin gjerminativ. Në përgjithësi kokrrat e polenit nuk shfaqur asnjë aktivitet (inicim të mbirjes, abortim apo mbirje të plotë) në fazat e fillimit të lulëzimit dhe lulëzimit të plotë. Aktiviteti i kokrrave të polenit është shfaqur vetëm në fazën e përfundimit të lulëzimit dhe atë me një përqindje të ulët. Në përqendrimet e saharozës 10 % dhe 15% zhvillimi i kokrrave të polenit ka qenë më i lartë se në përqendrimin 20 %. Gjatë 120 minutave të mbikëqyrjes së mbirjes së kokrrave të polenit, në intervalet kohore (10 – 20; 30 – 60 minuta) ka ndodhë pjesa dërmuese e incimit të mbirjes së kokrrave të polenit. Abortimi (shpërthimi) i kokrrave të polenit ka ndodhë më së tepërmi në intervalet kohore (30 – 50 dhe 60 – 120 minuta). Mbirja e plotë e kokrrave të polenit më së shumti ka ndodhë në mes (10 – 20; 30 – 40 dhe 60 – 120 minutave). Kjo tregon se kultivari Delishes i artë ndonëse përshkruhet një prej

polenizuesve më të mirë të mollës nuk ka treguar një potencial të lartë polenizues për kultivarët tjerë të mollës gjatë këtyre matjeve.

Fjalët kyçe: Molla, Delishes i artë, poleni, mbirja, saharoza, lulëzimi.